



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:266368
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05565260

C-IV-14-3296
Parashtruesi i kërkesës

S G, Kamenicë

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit- (AKP) (NSH “XIQ Karaqeva” në likuidim), Rr. ‘Dritan Hoxha’ nr.55, Lakërishtë. Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 12 prill 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI045-0939 datës 26 mars 2014.**
- III. Nuk caktohen shpenzime gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 29 prill 2014, ankuesi pranë DHPGJS, parashtror kërkesë për rishikimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) GJI045-0939 datë 26 mars 2014 (në tekstin e mëtutjeshëm Vendimi) me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin të tre (3) pagave të papaguara, për muajin maj, qershor dhe korrik të vitit 2006, në shumë prej 900.00 (nëntë zero zero) Euro, ndaj NSH “XIQ Karaqeva” (në likuidim).

Ankuesi me kërkesën e tij për rishikim i referohet Vendimit të AL, sipas numrit të protokoluar 12291 datë 26 mars 2014 gjersa Vendimin e AL nuk e ka parashtruar. Ankuesi kërkoj kompensimin e tre (3) pagave në shumë prej 900.00 (nëntë zero zero) Euro, tutje kërkoj kompensimin e katërbëdhjetë (14) pagave për periudhën 1998 gjer 1999 si dhe kompensimin e shumës për trustin e kursimeve pensionale të Kosovës për gjashtë (6) viteve.

Ankuesi pohon se pranë NSH ishte i punësuar nga data 1 shkurt 1979 e gjer në privatizimin e NSH me 15 gusht 2006.

Ankuesi, kundërshtoj Vendimin e AL lidhur me aplikimin e dispozitave mbi parashkrimin e kërkesës, duke pretenduar se zyrtarë të Agjencisë ju kanë pohuar se kërkesat e tyre mbi pagat nuk do të parashkruhen në asnjë mënyrë.

Nga të gjitha arsyet propozon që kërkesat e tij të aprovohen.

Kërkesës për rishikim i janë bashkangjitur:

- Tre kopje të kërkesave kreditore, drejtuar AKP,
- Kopje siç thuhet “Urdhër pune” (Radni Nalog), datë 2 tetor 1998 dhe 4 qershor 1997, në të cilat figuron emri i ankuesit,
- Një kopje e ankesës pa datë pranimi,
- Kopja e kërkesë për paga drejtuar AKP, e padatur dhe pa vulë pranimi,
- Kopja e Vërtetimi nr. 242 datë 17 prill 2013, lëshuar nga AKP,
- Kopja e Vërtetimit lëshuar nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale, datë 11 prill 2008,
- Kopja e Ekstraktit, siç thuhet mbi përcaktimin e të ardhurave personale dhe stazhin e sigurimit,
- Kopjen e librezës së punës, dhe
- Kopjen e Aktvendimit datë 10 dhjetor 1980, lëshuar nga NSH, për rritjen dhe përshtatjen e akontacionit të ardhurave personale.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës, ankuesi me parashtresën e tij datë 22 shtator 2021 parashtror kopjen e kërkuar të Vendimit të AL ndaj së cilës është parashtruar kërkesa për rishikim-ankesa.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 1 tetor 2021 parashtror përgjigjen.

AKP kundërshtoj ankesën si të pabazuar. AKP fillimisht pohon se AL ka bërë një vlerësim të saktë dhe ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të Shtojcës së Ligjit për AKP. Ankuesi, sipas AKP, në pajtim me nenin 40 1.6.1 të Shtojcës së Ligjit për AKP, duhet që pretendimet e tij ankimore, mbi pagat e pa-paguara, ti argumentoj. AKP përfundimisht pohoj se obligimet ndaj ankuesit janë parashkruar sipas dispozitave ligjore të Ligjit për punën e bashkuar - LPB. Nga gjitha AKP propozoj që ankesa të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Vendimi i AL.

Përgjigjes i është bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit të AL.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës ankuesi me 13 tetor 2021 parashtror përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP.

Ankuesi fillimisht kundërshtoj në tërësi si pranë kërkesës për rishikim-ankesës. Ankuesi pohon se i takon e drejta në kompensim dhe pretendimet e tij i mbështet në nenet 7, 14.2 dhe 33 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/48, nenit 28 dhe 31 të Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë, Ligjit për procedurën kontestimore dhe Ligjit për punën e bashkuar të vitit 1976.

Ankuesi përfundimisht me përgjigjen e tij kërkon kompensimin e tre (3) pagave të pa-paguara në shumë prej 900.00 (nëntë zero zero) Euro, përfshirë edhe kamatën ligjore.

AKP me 26 janar 2022 parashtroj kundërpërgjigjen.

AKP mbeti në tërësi si pranë përgjigjes së saj.

Duke ju referuar parashtrësës së AKP, së datës 8 shkurt 2022, lidhur me lëndën C-IV-14-2999, me së cilës i është bashkangjitur lista e punëtorëve të NSH, me dëshmitë mbi pagat e tyre e të cilët ishin punëtorë të saj, gjer me datën e privatizimit gjykata gjeti si në vijim:

- Nga lista e pagave e bashkangjitur, e cila listë është përpiluar nga ana e NSH, emri ankuesit nuk figuron në listën e punëtorëve të NSH. Këtu përfshihen Regjistri i të ardhurave personale të punëtorëve prej muajit janar 2004 e gjer në muajin qershor 2006, (në tekstin e mëtutjeshëm LISTA E PAGAVE TË PUNËTORËVE).

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Ankuesi, me përgjigjen ndaj përgjigjes së AKP, ashtu siç qëndron edhe në Vendimin e AL kërkon kompensimin e tre (3) pagave të pa-paguara në shumë prej 900.00 (nëntë zero zero) Euro Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuesit, që në parashtrësat e tij me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsytimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e tij. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesi, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij, mbi mos pagesën e të ardhurave personale.

Bazuar në LISTA E PAGAVE TË PUNËTORËVE, e parashtruar nga ana AKP por e përpiluar nga ana e NSH, tregon se ankuesi nuk ishte punëtor i regjistruar i NSH, gjer me datën e privatizimit të saj, qershor 2006.

Gjykata konsideroj se në rastin konkret dëshmitë e parashtruara përfshirë edhe librezat e punës nuk janë dëshmi e mjaftueshme që do të argumentonte të kundërtën e provave të parashtruara nga ana e AKP.

Andaj gjykata me rastin e vlerësimit të provave i dha besueshmëri provave të parashtruara nga ana e AKP.

Lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person të cilët janë pushuar nga puna si rrjedhojë e Vendimit për Likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga Agjencia sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP-në .

Nga dispozitat e lartcekura, mund të konkludohet se, punëtori/ja gëzon të drejtën në paga

respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar;

Ankuesi, nga dëshmitë e parashtruara, nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 por edhe nuk ka dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Taksa Gjyqësore:

Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit është 1,000.00 €.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar